

**Znj. Joniada Goçaj** ka përfunduar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor”, në degën Financë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Në vitin 2010 është diplomuar për Master i Nivelit të Dytë, Politikë e Jashtme & Diplomaci dhe në vitin 2018 është diplomuar në degën Drejtësi, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Në periudhën 2007-2014, znj. Goçaj ka punuar në sektorin privat, në pozicionin financiere.

Znj. Goçaj ka filluar punë në KLSH në tetor të vitit 2014, ku ka mbajtur pozicione të ndryshme si Auditues i Parë dhe Auditues i Lartë, si dhe ka qenë e angazhuar në të gjitha Departamentet e Auditimit, duke krijuar një eksperiencë dhe përvojë në auditim në të gjithë sektorët e administratës publike.

Aktualisht ushtron detyrën e “Kryeauditueses” në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Znj. Goçaj është e angazhuar edhe si pedagoge e jashtme për lëndën “Statistikë”, pranë Departamenti të Statistikës dhe Informatikë e Zbatuar, në Fakulteti e Ekonomisë Universiteti i Tiranës.

Gjatë karrierës së saj ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme ndërkombëtare për rritjen e kapacitetit profesional si:

- Në vitin 2019, ka ndjekur programin 5 mujor të “Internship-it” në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Departamentit të Financimit dhe Administrimit të Unionit (Chamber V: Financing and Administering the Union).

Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e jashtëm.

Znj. Goçaj është njohëse e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane.